

PASQYRAT FINANCIARE

nH EuroConsult sh.p.k.

Periudha 01/01/2015-31/12/2015

Tiranë, më Mars 2016

nH EuroConsult sh.p.k.

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Nr	A K T I V E T	nenim	2015	2014
	Aktivitet Afatshkurtra			
	► Aktivitet monetare	1	2,911,091.10	686,514.11
	1 Banka		2,645,477.79	637,176.80
	2 Arka		265,613.31	49,337.31
	► Investime	2		
	1 Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda	2.1		
	2 Aksionet e veta	2.2		
	3 Te tjera Financiare	2.3		
	► Të drejta të arkëtueshme	3	7,303,534.40	5,323,106.00
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	3.1	7,303,534.40	5,323,106.00
	2 Te tjera Kërkesa TVSH	3.2		
	3 Te tjera Kërkesa Tatim Fitim	3.3		
	4 Të tjera	3.4		
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar	3.5		
	► Inventarët	4	-	-
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumuesh	4.1		
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	4.2		
	3 Produkte të gatshme	4.3		
	4 Mallra	4.4		
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e maj	4.5		
	6 AAGJM të mbajtura për shitje	4.6		
	7 Parapagime	4.7		
	► Shpenzime të shtyra	5		
	► Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuar	6		
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		10,214,625.50	6,009,620.11
	Aktivitet Afatgjata			
	► Aktive financiare	7	-	-
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda	7.1		
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike br	7.2		
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka i	7.3		
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike k	7.4		
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	7.5		
	6 Tituj të tjerë të huadhënies	7.6		
	► Aktivitet materiale	8	7,378,089.00	7,234,213.00
	1 Toka dhe ndërtesa	8.1	1,117,800.00	
	2 Mjete transporti	8.2	3,025,688.00	3,782,110.00
	3 Instalime dhe pajisje	8.3	1,191,196.00	1,488,994.00
	4 Te tjera	8.4	2,043,405.00	1,963,109.00
	► Aktivitet biologjike	9		
	► Aktive jo materiale:	10	-	-
	1 Koncesione,patenta,liçenca,marka tregtare	10.1		
	2 Emri i Mirë	10.2		
	3 Parapagime për AAJM	10.3		
	► Aktive tatimore të shtyra	11		
	► Kapitali i nënshkruar i papaguar	12		
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		7,378,089.00	7,234,213.00
	AKTIVE TOTALE		17,592,714.50	13,243,833.11

ADMINISTRATORI

"NH EUROCONSULT" SH.P.K.

[Signature]

nH EuroConsult sh.p.k.

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	henim	2015	2014
►	Detyrime afatshkurtra:	13	1,771,264.77	1,246,538.42
1	Titujt e huamarrjes	13.1		
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	13.2		
3	Arkëtime në avancë për porosi	13.3		
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	1,047,049.77	59,377.81
5	Dëftesa të pagueshme	13.5		
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike të	13.6		
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike	13.7		
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurt	13.8	91,504.00	624,585.53
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	627,886.00	562,575.08
10	te tjera	13.10	4,825.00	
►	Të pagueshme për shpenzime të konstatu	14		
►	Të ardhura të shtyra	15		
►	Provizione	16		
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		1,771,264.77	1,246,538.42
►	Detyrime afatgjata:	17	-	-
1	Titujt e huamarrjes	17.1		
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	17.2		
3	Arkëtime në avancë për porosi	17.3		
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	17.4		
5	Dëftesa të pagueshme	17.5		
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike të	17.6		
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike	17.7		
8	Të tjera të pagueshme	17.8		
►	Të pagueshme për shpenzime të konstatu	18		
►	Të ardhura të shtyra	19		
►	Provizione:	20	-	-
1	Provizione për pensionet	20.1		
2	Provizione të tjera	20.2		
►	Detyrime tatimore të shtyra	21		
	Totali i Detyrimeve afatgjata		-	-
	DETYRIMET TOTALE		1,771,264.77	1,246,538.42
►	Kapitali dhe Rezervat	22	11,997,294.69	9,054,098.67
►	Kapitali i Nënshkruar	22.1	100,000.00	100,000.00
►	Primi i lidhur me kapitalin	22.2		
►	Rezerva rivlerësimi	22.3		
►	Rezerva të tjera	22.4	11,897,294.69	8,954,098.67
1	Rezerva ligjore	22.4.1		
2	Rezerva statutore	22.4.2		
3	Rezerva të tjera	22.4.3	11,897,294.69	8,954,098.67
►	Fitimi i pashpërndarë	23		
►	Fitim / Humbja e Vitit	24	3,824,155.24	2,943,196.02
	Totali i Kapitalit		15,821,449.93	11,997,294.69
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		17,592,714.70	13,243,833.11

ADMINISTRATORI

"NH EUROCONSULT" SH.P.K.

[Signature]



nH EuroConsult sh.p.k.

Pasqyra e Performancës

(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	henime	2015	2014
►	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	32,478,090.00	19,684,584.33
►	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatsh	30		
►	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapi	31		
►	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32		
►	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33		
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumues	33.1		
	2 Të tjera shpenzime	33.2		
►	Shpenzime të personelit	34	4,210,968.00	5,274,238.00
	1 Paga dhe shpërblime	34.1	3,744,000.00	4,826,000.00
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shënd	34.2	466,968.00	448,238.00
	nga shpenzimet për pensionet)			
►	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	35		
►	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	1,523,924.00	1,739,961.00
►	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	21,989,143.88	9,416,678.29
►	Të ardhura të tjera	38		
	1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka in	38.1		
	veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike			
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tje	38.2		
	(paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë			
	3 Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të	38.3	1,168.99	246,469.92
	veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike			
►	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investim	39		
►	aktive afatshkurtra			
►	Shpenzime financiare	40		
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngj	40.1		
	shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekon			
	2 Shpenzime të tjera financiare	40.2	86,958.87	
►	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41		
►	Fitimi/Humbja para tatimit	42	4,668,264.24	3,500,176.96
►	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	844,109.00	556,980.94
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	43.1		
	2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë	43.2		
	3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve	43.3		
►	Fitimi/Humbja e vitit	44	3,824,155.24	2,943,196.02
►	Fitimi/Humbja për:	45		
	Pronarët e njësise ekonomike mëmë	45.1		
	Interesat jo-kontrolluese	45.2		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve		2015	2014
►	Fitimi/Humbja e vitit	46	3,824,155.24	3,500,176.96
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	46.1		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në vep	46.2		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	46.3		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare	46.4		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesën	46.5		
►	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për	47	-	-
►	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	48	3,824,155.24	3,500,176.96
►	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse p	49		
	Pronarët e njësise ekonomike mëmë	49.1		
	Interesat jo-kontrolluese	49.2		

ADMINISTRATORI

"NH EUROCONSULT" SH.P.K.

nH EuroConsult sh.p.k.

		Kapitali aksionar	rezervat ligj	mi pashperno	Fitimi ushtrimor	TOTALI
III	Pozicioni me 31 dhjetor 2010	100,000			3,182,626	3,282,626
1	Fitimi neto per periudhen kontabel				1,164,081	1,164,081
2	Rritje rezerva		3,182,626		-3,182,626	
3	Dividentet e paguar					
4	Emetimi kapitali aksionar					0
III	Pozicioni me 31 dhjetor 2011	100,000	3,182,626	0	1,164,081	4,446,707
1	Fitimi neto per periudhen kontabel				2,460,780	2,460,780
2	Rritje rezerva		1,164,081		-1,164,081	0
3	Dividentet e paguar					
4	Emetimi kapitali aksionar					0
III	Pozicioni me 31 dhjetor 2012	100,000	4,346,707	0	2,460,780	6,907,487
1	Fitimi neto per periudhen kontabel				2,146,612	2,146,612
2	Rritje rezerva		2,460,780		-2,460,780	0
3	Dividentet e paguar					
4	Emetimi kapitali aksionar					0
IV	Pozicioni me 31 dhjetor 2013	100,000	6,807,487	0	2,146,612	9,054,099
1	Fitimi neto per periudhen kontabel				2,943,196	2,943,196
2	Rritje rezerva		2,146,612		-2,146,612	0
3	Dividentet e paguar					
4	Emetimi kapitali aksionar					0
IV	Pozicioni me 31 dhjetor 2014	100,000	8,954,099	0	2,943,196	11,997,295
1	Fitimi neto per periudhen kontabel				3,824,155	3,824,155
2	Rritje rezerva		2,943,196		-2,943,196	0
3	Dividentet e paguar					
4	Emetimi kapitali aksionar					0
IV	Pozicioni me 31 dhjetor 2015	100,000	11,897,295	0	3,824,155	15,821,450

ADMINISTRATORI
"NH EUROCONSULT" SH.P.K.



Pasqyra e Fluksit Monetar - Metoda Indirekte 2015

Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Indirekte	Periudha	Periudha
	Raportuese	Paraardhse
Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	4,668,264.24	3,500,176.96
Rregullime per :		
Amortizimin	1,523,924.00	1,739,961.00
Humbje nga kembimet valutore		
Te ardhura nga Investimet		
tatim fitim i llogaritur	- 844,109.00	- 556,980.94
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketues - nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	1,980,428.40	1,998,734.00
Rritje/renie ne Tepricen e inventarit		
Rritje/renie ne parapagime dhe shpenzime te shtyra nga aktiviteti		
Rritje/renie ne huadhenie te tjera		
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve , per tu paguar nga aktiviteti	524,726.15	- 6,355,932.30
Tatim mbi fitimin i paguar		
MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit	3,892,376.99	325,958.72
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese	- 1,667,800.00	- 292,703.00
Blerja e njesisese kontrolluar X minus parate e Arketuara		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	- 1,667,800.00	- 292,703.00
Te ardhura nga shitja e paisjeve		
Interesi i arketuar		
Dividentet e arketuar		
MM neto te perdoruara ne veprimtarite investuese		
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
Te ardhura nga huamarrje afatgjata		
Pagesat e detyrimeve te qerases financiare		
Dividente te paguar		
MM neto e perdorur ne veprimtarite Financiare		
Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	2,224,576.99	33,255.72
Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	686,514.11	653,258.39
Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	2,911,091.10	686,514.11

ADMINISTRATORI
"NH EUROCONSULT" SH.P.K.

Shenimet Shpjeguese per Pasqyrat Financiare

Per vitin ushtrimor 01 Janar 2015 - 31 Dhjetor 2015

(Te gjitha balancat jane ne leke)

Dhenia e shenimeve shpjeguese ne kete pjese eshte e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar Plotesimi i te dhenave te kesaj pjese duhet te behet sipas kerkesave dhe strukture standarte te percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Radha e dhenies se spjegimeve duhet te jete:

1. Informacion i pergjithsem dhe politikat kontabel
2. Shenimet qe shpjegojne zerat e ndryshem te pasqyrave financiare
3. Shenime te tjera shpjeguese

1. Informacion i pergjithshem dhe politikat kontabel

a. Informacion i pergjithshem per shoqerine

Shoqeria NH EuroConsult sh.p.k.(ish AIEI AUDITORS sh.p.k.), eshte e regjistruar ne Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.28.655 me date 12.12.2002; me seli e vendndodhje kryesore te aktivitetit ne adresen : Rruga Brigada e Tete, Pall 8/1,Tirane. Znj.Nexhmije Cela dhe Z. Hysen Cela jane administrator te shoqerise. Ka si objekt kryesor veprimtarine ne fushen e ekspertizave kontabel. Shoqeria eshte e regjistruar prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane me NIPT K31516059K.

b. Politikat kontabel te vena ne zbatim gjate ushtrimit kontabel 2015.

- Kuadri ligjor : Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Legjislacioni tatimor ne fuqi si Ligji Nr. 8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat", i ndryshuar si dhe gjithë paketës ligjore fiskale ne fuqi pergjate periudhës ushtrimore kontabel 2015.
- Kuadri kontabel i aplikuar : Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara ne Shqiperi, SKK hyre ne fuqi nepermjet Urdhrit nr 64, dt 22.07.2014 "Per shpalljen e Standardeve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara dhe zbatimin e detyrueshem te tyre". Ha rtimi i PF 2015 eshte bere ne perputhje me kerkesat e SKK1 "Kuder i pergjithshem per pergatitjen e PF" dhe SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare".
- Parimet baze gjate pergatitjes se PF : Parimi i te drejtave dhe detyrimet e konstatuara, Parimi i njohjes se shpenzimeve ne te njejten periudhe ushtrimore ne te cilen njihen dhe vleresohen ne menyre te besueshme te ardhurat perkatese, Parimi i koston historike te amortizuar, Parimi i njesise ekonomike, Parimi i vijimesise se aktivitetit, Parimi i kompensimit.
- Disa nga karakteristikat cilesore te Pasqyrave Financiare 2015 jane: Kuptueshmeria per perdoruesit e informacionit, Rendesia dhe Materialiteti, Besueshmeria, Perparesia e permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmeria, Plotesia, Maturi, Qendrueshmeria e politikave kontabel dhe Krahueshmeria nder vite.
- Paraqitja e informacionit financiar raportohet ne monedhen vendase, LEKE, si kerkese ligjore e Ligjit per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare ne Republiken e Shqiperise.

Paketa e plote e Pasqyrave Financiare dhe Shnimeve Shpjeguese per vitin 2015 ka si objektiv te pasqyroje nje pamje te vertete e te drejte te infomacionit financiar, duke u perbehere nga :

- I. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilancit Kontabel) ne te cilen pasqyrohen Aktivet e shoqerise si dhe format e financimit te tyre, nepermjet fondeve te veta (kapital) apo atyre te huazuara (Detyrimet).
- II. Pasqyra e Performances (Pasqyra e Te Ardhurave Totale) ne te cilen pasqyrohet performanca ekonomike e shoqerise nepermjet rezultatit neto te realizuar, bazuar ne te ardhurat dhe shpenzimet e kryera gjate vitit ushtrimor 2015.
- III. Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare, e cila pasyron flukset neto te parase nga aktivitetet e shfrytezimit, investimit dhe financimit.
- IV. Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital Neto tregon ndryshimet ne kapitalin e Shoqerise 2RC shpk per periudhen 01 Janar 2015 - 31 Dhjetor 2015.

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te zbatuara ne Pasqyrat financiare paraqiten si me poshte:

Mjetet Monetare.

Njohja, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i ketij instrumenti financiar eshte bere ne perputhje me paragrafet nr 11-21 te SKK-se se permiresuar nr.3 "Instrumentat Financiare". Teprica debitore e mjeteve monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise me date raportimi 31.12.2015. Cdo transaksion ne monedhe te huaj i kryer gjate periudhes ushtrimore eshte kryer ne perputhje me SKK i permiresuar nr 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit" paragrafet 13-18.

Te drejta te Arketueshme

Njohja e aktiveve financiare, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i tyre realizohet duke mbajtur ne konsiderate kerkesat e SKK e permiresuar nr 3 "Instrumentata Financiare", paragrafet nr 11-21. Per vleresimin e tyre eshte perdorur metoda e koston se amortizuar. Perkthimi i instrumentave financiare te arketueshem ne monedhe te huaj me kursin e dates se raportimit, shpallur me 31.12.2015 nga Banka e Shqiperise mban ne konsiderate kerkesat e SKK i permiresuar nr 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit" paragrafet 13-18.

Inventari

Per Tepricen debitore te zerit Inventare, paraqitur ne PF, ne daten e raportimit 31.12.2015 jane zbatuar parimet e njohjes, matjes dhe vleresimit te mepasshem ne perputhje me SKK-se se permiresuar nr.4 "Inventaret", paragrafet 8-33.

Kosto e inventareve te perdorur gjate periudhe dhe gjendjes ne daten e raportimit te PF, eshte matur-vleresuar duke perdorur metoden e koston mesatare te ponderuar.

Aktivitet Afatgjata Materiale

Per trajtimin kontabel gjate dhe ne fund te periudhes raportuese, qe nga momenti i njohjes per here te pare te tyre ne librat kontabel, duke vijuar me tej me matjen e vleresimin e tyre ne dalje dhe ne daten e raportimit financiar me metoden e Koston se Amortizuar, ne perputhje me SKK nr 5 "Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale" e permiresuar, paragrafet 8-54. Pasqyrimi i tyre ne PF eshte bere me Vleren

Kontabel Neto ne daten e raportimit. Ne metoden e llogaritjes se amortizimit jane mbajtur parasysh dhe kerkesat e Ligjit nr 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, neni 22, sipas metodes se pergjindjes mbi vleren e mbetur te aktivitetit.

Detyrimet afatshkurtra.

Njohja e detyrimeve afatshkurtra financiare, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i tyre realizohet duke mbajtur ne konsiderate kerkesat e SKK e permiresuar nr 3 "Instrumentata Financiare", paragrafet nr 11-21. Per vleresimin e tyre eshte perdorur metoda e koston se amortizuar. Perktimi i instrumentave financiare te pagueshem ne monedhe te huaj me kursin e dates se raportimit, shpallur me 31.12.2015 nga Banka e Shqiperise mban ne konsiderate kerkesat e SKK i permiresuar nr 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit" paragrafet 13-18.

Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel ne perputhje me SKK nr 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare" e permiresuar, SKK nr 2 "Paraqija e Pasqyrave Financiare" dhe SKK nr 8 "Te Ardhurat" per njohjen dhe evidentimin e rezultatit neto te periudhes ushtrimore.

Te Ardhurat dhe Shpenzimet.

Vleresimi i te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes. Vleresimi i tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35-37 te SKK nr 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare" e permiresuar si edhe te SKK nr 8 "Te Ardhurat" per njohjen dhe matjen e te ardhurave te realiuara gjate periudhes ushtrimore.

Te ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas parimit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara. Te ardhurat nga shitja e mallrave, materialeve apo sherbimeve njihen kur i jane kaluar blesit te gjitha rreziqet dhe perfitimet, maten me besueshmeri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve, paragrafi 16-19 i SKK 8 i permiresuar. Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve njihen ne varesi te fazes, ne te cilen ndodhet kryerja e sherbimit ne daten e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet qe lidhen me sherbimin mund te perlogaritet me besueshmeri, referua paragrafet 20-43 te SKK 8 i permiresuar. Te ardhurat vleresohen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e kthimeve dhe uljeve te ofruara. Shpenzimet njihen ateher kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njeitin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura, referuar paragrafet nr 37-39 te SKK 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare".

Transaksionet ne monedhe te huaj

Referuar SKK 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit", paragrafi nr 11 "Nje transaksion ne monedhe te huaj ne njohje, regjistrohete ne monedhen funksionale, duke zbatuar mbi shumen e monedhes se huaj kursin e menjehershme te kembimit (spot) ndermejt monedhes funksionale dhe monedhes se huaj ne daten e transaksionit. Vijohet me tej me raportimin ne fund te periudhave raportuese te mepasshme, paragrafi nr 13 duke:

- perkthyer zerat monetare te shprehur ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit te mbylljes (ne daten e raportimit)
- perkthyer zerat jomonetare qe mate me koston historike ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit,

- perkthyer zerat jomonetare qe maten me vleren e drejte ne monedhe te huaj duke perdorur kursin e kembimit ne daten kur eshe percaktuar vlera e drejte.

Njohja e diferencave nga kurset e kembimit, referuar paragrafit 15-16, qe krijohen gjate shlyerjes se zerave monetare ose gjate perkthimit te zerave monetare me kurse kembimi te ndryshme nga kurset e kembimit, me te cilat ato jane perkthyer ne njohjen gjate periudhes kontabel aktuale, ose ne PF te meparshme, njohen si fitim (humbje) te periudhes kontabel kur ato lindin. Kur nje ze monetar rrjedh nga nje transaksion ne moendhe te huaj, dhe ka nje ndryshim ne kursin e kembimit mes dates se kryerjes se transkasionit dhe dates se shlyerjes se tij, atehere krijohet nje difference kembimi. Kur transaksioni shlyeht ne te njejtejn periudhe kontabel, ne te cilen ai eshte kryer, e gjithje diferenca e kembimit njihet ne te njejtejn periudhe kontabel. Megjithate, kur nje transkasion shlyeht ne nje periudhe kontabel te mepasshme, diferenca e kembimit, e njohur ne secilen periudhe deri ne daten e shlyerjes, percaktohet nga ndryshimi i kurseve te kembimit gjate seciles periudhe kontabel.

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne LEK dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Mjetet monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne LEK me kursin e kembimit te percaktuar nga Banka e Shqiperise ne daten e bilancit. Pra, ne çdo date bilanci, zerat monetare te bilancit te shprehur ne monedhe te huaj rivleresohen me kursin zyrtar te kembimit ne daten e bilancit. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te kompanise si diferenca te realizuara nga kursi kembimit.

Zera te tjere jo monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne LEK duke perdorur kursin e kembimit te percaktuar nga Banka e Shqiperise ne daten e Bilancit Kontabel. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te kompanise si diferenca te realizuara nga kursi kembimit.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e zerave te bilancit ne monedhe te huaj ishin si me poshte vijon:

- 1EUR=137.28 LEK
- 1USD=125.79 LEK

1. Aktive monetare

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2015 paraqiten si vijon:

Te drejta te arketueshme:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Arka	LEKE	265,613.31	49,337.31
Banka	LEKE	2,645,477.79	637,176.80
Shuma		2,911,091.10	686,514.11

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me tepricat e llogarive bankare dhe inventaret fizike te mjeteve monetare ne arken e kompanise. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne monedhen vendase, leke, duke perdorur kursin e kembimit te dates se Pasqyrave Financiare (31.12.2015) publikuar sipas Bankes se Shqiperise. Njohja, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i ketij instrumenti financiar eshte bere ne perputhje me paragrafet nr 11-21 te SKK-se se permiresuar nr.3 "Instrumentat Financiare".

Shoqerise i kryen transaksionet bankare ne INTESA SANPAOLO BANK., Credins dhe ne B.K.T.

2. Te drejta te arketueshme:

Te drejtat e arketueshme dhe kerkesa te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore kontabel 2015 deklarohen si vijon:

Te drejta te arketueshme:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Llogari te arketueshme (1) nga aktiviteti I shfrytezimit	LEKE	7,303,534.40	5,323,106
Shuma		7,303,534.40	5,323,106

Ne zerin "Te drejta te arketueshme" jane pasqyruar te drejtat (llogarite e arketueshme) qe njesia ekonomike ka ndaj te treteve si pasoje e aktivitetit te shfrytezimit dhe te tjera, ku permendim Klientet per detyrimet e pashlyera ndaj furnizimeve te faturuara gjate vitit ushtrimor 2015, te drejta tatimore si dhe te drejta te tjera te huadhenies. Njohja e aktiveve financiare, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i tyre realizohet duke mbajtur ne konsiderate kerkesat e SKK e permiresuar nr 3 "Instrumentata Financiare", paragrafet nr 11-21. Per vleresimin e tyre eshte perdorur metoda e koston se amortizuar.

Llogaria sintetike e Klienteve me 31 Dhjetor 2015 rakordon me ato analitike te dates 31.12.2015

5. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet e Aktiveve Afatgjata Materiale ne Pasqyrat Financiare per vitin 2015, paraqitet si vijon:

Aktivet Afatgjata Materiale	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Toka dhe ndertesa	LEKE	1,117,800	
Mjete transporti	LEKE	3,025,688	3,782,110
Instalime dhe pajisje	LEKE	1,191,196	1,488,994
Te tjera	LEKE	2,043,405	1,963,109
Shuma		7,378,089	7,234,213

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2015. Per trajtimin kontabel gjate dhe ne fund te periudhes raportuese, qe nga momenti i njohjes per here te pare te tyre ne librat kontabel, duke vijuar me tej me matjen e vleresimin e tyre ne dalje dhe ne daten e raportimit financiar me metoden e Kostos se Amortizuar, ne perputhje me SKK nr 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" e permiresuar, paragrafet 8-54. Pasqyrimi i tyre ne PF eshte bere me Vleren Kontabel Neto ne daten e raportimit. Ne metoden e llogaritjes se amortizimit jane mbajtur parasysh dhe kerkesat e Ligjit nr 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, neni 22, sipas metodes se pergjithshme mbi vleren e mbetur te aktivitetit.

Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne asete eshte bere me koston e blerjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar, si dhe pasqyrohen aktivet e blera gjate vitit me fatura tatimore shetje dhe daljet e tyre dhe per aktivet e bera dalje eshte llogaritur amortizimi deri ne daten e fundit qe keto aktive kane qene ne perdorim te kompanise dhe aktivitetit ekonomik.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim-kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

7. Detyrime afatshkurtera

Zeri i detyrimeve afatshkurtra ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor kontabel 2015 paraqiten si me poshte vijon:

Detyrimet afatshkrutra:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	LEKE	-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	LEKE	1,047,049.77	59,377.81
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	LEKE	91,504	624,585.53
Te pagueshme per detyrimet tatimore	LEKE	627,886	562,575.08
Te tjera	LEKE	4,825	
Shuma		1,771,264.77	1,246,538.42

Zerat qe perbejne "Detyrimet afatshkrutra" te cilet jane siperpermendur detajohen ne vijim me llogarite perkatese analitike.

Detyrimet ndaj institucioneve te kredise paraqet shumen e huamarrjes me 0 leke.

"Te pagueshme ndaj furnitoreve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve, qe rezultojne pa shlyer ne daten e raportimit te PF, 31.12.2015. Shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Tepricat e llogarive jane rakorduar me furnoret perkates. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara me vertetesi dhe besueshmeri. Furnoret e mbajtur ne monedhe jane azhornuar me kursin e dates se Bilancit Kontabel te publikuar nga Banka e Shqiperise, ne zbatim te kerkesave te SKK i permiresuar nr 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit" paragrafet 13-18.

Detyrimet e pasqyruara ne tabelen e mesiperme, perbehen nga Detyrimet per derdhjen e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore e Shendetesore per muajin Dhjetor 2015, te cilat deklarohen dhe paguhet deri ne daten 20 Janar 2016, qe rezulton nje vit i ndryshem kontabel nga lindja e detyrimit. Detyrime te periudhave te meparshme te pashlyera nuk ka.

Detyrimet tatimore perbehen nga detyrimi i papaguar i Tatimit mbi te ardhurat nga punesimi, Tatimi i mbajtur ne Burim dhe tatim mbi fitimin.. Keto detyrime vijne si rezultat i deklarimit dhe pageses se tyre deri ne daten 20 te muajit pasardhes, konkretisht Janar 2016 per periudhen Tatimore Dhjetor 2015. Detyrime te meparshme tatimore nuk rezultojne, ato jane paguar ne kohe, duke respektuar kerkesat e legjislacionit tatimor ne fuqi. Detyrime tatimore te tjera te periudhes nuk rezultojne pasi ato evidentohen si te drejta, pasqyruar ne aktiv te Pasqyres se Pozicionit Financiar. Perllogaritja e detyrimeve tatimore eshte realizuar ne perputhje me legjislacionin tatimor ne fuqi.

9. Kapitallet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i nenshkuar e i paguar dhe elementet e tjere te seksionit te Kapitalit, paraqitur ne Pasqyren e Pozicionit Financiar dhe Pasqyren e Levizjeve te Kapitalit, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR.

– Kapitali i nenshkuar eshte vendosur teprica e llogarise Kapitali themeltar ne vleren 100.000,00 leke e njejte me ate te vitit te kaluar.

– Rezerva te tjera eshte vendosur teprica e llogarise rezerva ligjore ne vleren 11,897,294.69 leke e rritur ne krahasim me vitin te kaluar per fitimin e vitit 2014 2,943,196.02 leke, sipas vendimit te ortakut.

– Fitimi i vitit financiar eshte vendosur teprica e llogarise fitime dhe hunjte te vitit ushtrimor ne vleren 3,824,155.24 leke .

Pasqyra e Performances (Te ardhurave dhe Shpenzimeve) viti 2015

Vleresimi i te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes. Vleresimi i tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 35-37 te SKK nr 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare" e permiresuar si edhe te SKK nr 8 "Te Ardhurat" per njohjen dhe matjen e te ardhurave te realiuara gjate periudhe ushtrimore.

1. Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate vitit ushtrimor, bazuar ne dokumentacionin justifikues perkates (faturimet ndaj klienteve), ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore kontabel 2015 paraqiten si me poshte vijon:

Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
Te ardhurat nga aktiviteti	LEKE	32,478,090	19,684,584.33
Shuma		32,478,090	19,684,584.33

Ne kete tabele perfshihen te ardhurat e realizuara gjate vitit ushtrimor 2015 ne lidhje me shitje e mallrave, sherbime te fatururara me Fature Tatimore Shitje me TVSH. Te ardhurat nga shitja e mallrave, materialeve apo sherbimeve njihen kur i jane kaluar blesit te gjitha rreziqet dhe perfitimet, maten me besueshmeri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve, paragrafi 16-19 i SKK 8 i permiresuar. Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve njihen ne varesi te fazes, ne te cilen ndodhet kryerja e sherbimit ne daten e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet qe lidhen me sherbimin mund te perlogaritet me besueshmeri, referua paragrafet 20-43 te SKK 8 i permiresuar. Te ardhurat vleresohen me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumen e kthimeve dhe uljeve te ofruara..

Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Shpenzimet njihen ateher kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura, referuar paragrafet nr 37-39 te SKK 1 "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e Pasqyrave Financiare" Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave dhe sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar ne Listepagesat mujore. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Duke perdorur klasifikimin sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2015 jane evidentuar ne Pasqyren e Performances.

Kosto e punes

Shoqeria ka lidhur kontrata pune dhe ka paguar punonjesit e saj konform dispozitave ligjore. Per ata jane derdhur prane organeve tatimore detyrimet per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe jane mbajtur ndalesat per keto kontribute si dhe per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi rregullisht.

Shpenzime te personelit:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Pagat e personelit	LEKE	3,744,000	4,826,000
Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore	LEKE	466,968	448,238
Shuma			

Dokumentacioni baze justifikues per evidentimin dhe matjen me besueshmeri te ketyre shpenzimeve jane

Listepagesat mujore te deklaruarat prane organeve tatimore per periudhen Janar-Dhjetor 2015.

Shpenzime AMORTIZIMI

Shpenzime AMORTIZIMI	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Shp enzime amortizimi	LEKE	1,523,924	1,739,961
Shuma		1,523,924	1,739,961

Shpenzime te tjera

Zeri i shpenzimeve te tjera ne Pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve per vitin 2015 dhe 2014 pasqyrohet i detajuar si me poshte vijon:

Shpenzime te tjera shfrytezimi:	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
Shpenz. Te te trete.	LEKE	13,151,667	4,483,773
Shpenz. Karburanti , rip.	LEKE	900,332	660,221
Shpenzime per taksa vendore	LEKE	34,080	25,120
Shpenzime taxa IEKA	LEKE	577,000	431,000
Shpenzime per qera	LEKE	2,880,000	2,800,000
Shpenzime te panjohura	LEKE	959,126	213,029.30
Shpenzime per pritje dhe dhurata	LEKE	40,750	
Udhetime dieta	LEKE	1,947,000	635,000
Te tjera rrjedhese	LEKE	1,489,188.88	168,534.99
Shuma		21,989,143.88	9,416,678.29

Shpenzimet dhe te ardhurat financiare

Shpenzimet financiare per vitin 2015 dhe 2014 pasqyohen si me poshte vijon:

Shpenzime të tjera financiare	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Shpenzime interesi	LEKE		
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	LEKE	86,958.87	-
Shuma		86,958.87	-
Te ardhura të tjera financiare	Monedha	Gjendja ne 31.12.2015	Gjendja ne 31.12.2014
		Ne leke	Ne leke
Te ardhura te tjera financiare	LEKE	1,168.99	246,469.92
Shuma		1,168.99	246,469.92

Njohja e diferencave nga kurset e kembimit, referuar paragrafit 15-16, te SKK 12 "Efekti i ndryshimeve te kurseve te kembimit", i permiresuar, qe krijohen gjate shlyerjes se zerave monetare ose gjate perkthimit te zerave monetare dhe jomonetare me kurse kembimi te ndryshme nga kurset e kembimit, me te cilat ato jane perkthyer ne njohjen gjate periudhes kontabel aktuale, ose ne PF te meparshme, njohen si fitim (humbje) te periudhes kontabel kur ato lindin. Kur transaksioni shlyeht ne te njejtejn periudhe kontabel, ne te cilen ai eshte kryer, e gjithë diferenca e kembimit njihet ne te njejtejn periudhe kontabel. Megjithate, kur nje transkasion shlyeht ne nje periudhe kontabel te meparshme, diferenca e kembimit, e njohur ne secilen periudhe deri ne daten e shlyerjes, percaktohet nga ndryshimi i kurseve te kembimit gjate seciles periudhe kontabel.

Fitimi i ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2015 dhe 2014 analizohen si vijon:

Nr.	Llogaritja e Tatim fitimit	Monedha	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014
I	Fitimi neto para Tatimit	LEKE	4,668,264.24	3,500,176.96
II	Shpenzime te pazbritshme:	LEKE	959,126	230,029.29
III	PJESA E HUMBYES SE MBARTUR 2013	LEKE		
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	LEKE	5,627,390.24	3,713,206.27
V	Shpenzimi i tatim fitimit-15%	LEKE	844,109	556,980.94
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	LEKE	51,162,973	8,924,684.61

Shpenzimi i Tatim fitimit te periudhes ushtrimore 2015 eshte llogaritur mbi fitimin e tatueshem pasi fitimit kontabel i jane shtuar shpenzimet e panjohura, referuar Legjislacionit tatimor ne fuqi ne lidhje me Tatimin mbi te Ardhurat. Ky detyrim pakesohet me shumen e parapagimit me teper te Tatim fitimit ne vitin 2015, si me poshte vijon.

NH EuroConsult sh.p.k.

ADMINISTRATORI

Nexhmije CELA


